

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Elmaz Zenuni, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. S, për shkak të veprës penale vrasja nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, PP nr.401-2/2010 të datës 28 shtator 2010, në prezencën e Prokurorit të Agron Çalaj, të akuzuarit B. S, mbrojtësi i tij me autorizim av. A. I, përfaqësuesi i të ndjerës vëllai i saj Z. S, si edhe të dëmtuarit e tjerë fëmijëve të së ndjerës A. S, I. S, Sh. S dhe R. S pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 25/26 mars si dhe 23/24 prill 2013, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari B. S**, nga i ati ..... dhe e ëma ..... e gjinisë ....., i lindur më ....., në fshatin ..... Komuna Ferizaj, ku edhe jeton, i martuar baba i nëntë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, zdrukthetare, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

1. Sepse me datën 02.07.2010, rreth orës 13:25 minuta, në shtëpinë e tij në fshatin ..... Komuna e Ferizajt, pas një fjalosje me bashkëshorten e tij, tani të ndjerën H. S, si pasojë e mos përmbushjes së obligimit nga ana e mikut të tij- gjegjësisht vëllait të së ndjerës Z. S, i cili ka pas me ia dhënë të pandehurit veturën e markës “.....” pasi që i pandehuri për të njëjtën veturë Z.. ia ka dhënë 5000 euro, tri vetura dhe dy motorra të veturave, për këtë shkak se i pandehuri fillimisht e ka rrah të ndjerën e pastaj, me dashje që ta privojë nga jeta e merr pushkën e gjuetisë nga kuzhina me cilën drejtohet tek dhoma e fjetjes përderisa e dëmtuara – tani e ndjera ishte ulur në kauç, nga distanca prej 1.5 m deri në 2 m ia drejton të njëjtën në fytyrë, e shkrep njëherë ku i shkakton lëndime të rënda trupore, shkak i të cilave të njëjtën ditë e ndjera ndërron jetë në QKUK në Prishtinë.

- **me të cilën kreu veprën penale vrasja nga neni 146 të KPK-së.**

2. Që nga data e pavërtetuar e gjer më 02.07.2010, kur i pandehuri ka privuar nga jeta tani të ndjerën bashkëshorten e tij – H. S, në shtëpinë e tij në fshatin ..... Komuna e Ferizajt, ka mbajtur në pronësi pushkën pa leje valide për mbajtje të autorizuar të armëve pushkën e gjuetisë, prodhim rus, me nr. serik ....., dy tytshë e cal. 12mm.

- **me të cilën ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 328 par. 2 të KPK-së.**

**Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 146, 328 par. 2 si dhe neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 71, 73 të KPK-ës dhe nenit 391 të KPPK-ës,**

### **CAKTON**

Për veprën penale në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 12 /dymbëdhjetë/vite.

Për veprën penale në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/vit e 6/gjashtë/muaj.

**Ashtu që në bazë të nenit 71 par.1 të KPK-së, i**

### **SHQIPTON**

**DËNIM UNIK BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 13/TREMBËDHJETË/VITE,**

Në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 02.07.2010, e tutje kurse në bazë të nenit 393 par.5 të KPPK-së, Gjykata me aktvendim të veçantë ka vazhduar masën e paraburgimit, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

Konform nenit 328 par. 5 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma e gjuetisë e tipit "TOZ-345P" e kalibrit 12 BORE me dy tyta vertikale me numër serik .....

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100/njëqind/€, kurse shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 350.06€, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës-vëllai i saj Z. S dhe vajza e të ndjerës I. S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil, kurse të dëmtuarit A. S, Sh. S, R. S nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridik.

### **A r s y e t i m i**

#### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP nr.401-2/2010 të datës 28.09.2010, ndaj të akuzuarit B. S, për shkak të veprës penale vrasja nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Me aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr. 227/10 të datës 28.10.2010, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarit B. S, për shkak të veprës penale në vrasja nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 25/26 mars si dhe 23/24 prill 2013, kurse Prokurori i Shtetit Agron Çalaj, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Prokurori i Shtetit deri në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit B. S, për shkak të veprës penale vrasja nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohen dënime të parapara me ligj për këto vepra penale.

## **2. Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari B. S, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja nga neni 146 të KPK-së dhe veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, por duke mohuar gjatë tërë mbrojtjes së tij (edhe në fazën hetimore) që vrasjen e ka kryer me dashje, më tutje ka sqaruar rrethanat si kanë ndodhur në ditën kritike, duke mos e kontestuar faktin se me ish bashkëshorten e tij kanë zhvilluar një bisedë së pari në dhomën-sallonin e shtëpisë së tyre, e që përmbajtja e kësaj bisede ishte rreth ndërrimit të automjeteve, që i akuzuari kishte bërë me vëllain e të dëmtuarës. Pas disa minutave e ndjera ka dal në korridor, përkatësisht fëmijët e kanë larguar nga salloni dhe shtirë në dhomën e fjetjes së djalit të tij (Sh), e që në një moment derisa fëmijët ishin duke biseduar me tani të ndjerën, i akuzuari ka dëgjuar fjalinë nga e ndjera “ti kapin pushkët”, e pas kësaj ka kapur pushkën e gjuetisë e cila ka qenë e vendosur afër komodes së TV dhe me pushkë në dorë kanë zhvilluar një bisedë, fillimisht duke qëndruar që të dy në këmbë, e më pas e ndjera është ulur në kauç, kurse i akuzuari është ulur në gjunjë para saj, duke vendosur pushkën nën sqetull, e derisa në një moment duke u ngritur në këmbë, e që i akuzuari nuk mund të jep sqarime se a e ka shkelur rripin e pushkës apo pushka e ka prekur për karrige apo në një mjet tjetër, por pushka ka shkrepur një herë, me ç’rast e ka qëlluar të ndjerën në pjesën e majtë të fytyrës, duke i shkaktuar plagë pas të cilave edhe vdes të njëjtën ditë.

Sa i përket raporteve në mes tij dhe bashkëshortes së tij, ia akuzuari raportet i ka përshkruar se kanë qenë raporte të mira dhe nuk kanë pasur probleme në mes vete, derisa ka ardhur deri tek marrëveshja (pazari) për ndërrimin e automjeteve që ka ndodhur në mes të akuzuarit dhe Z. S (vëllait të ndjerës). I akuzuari më tutje në mbrojtjen e tij shton se, tani e ndjera bashkëshortja e tij gjatë tërë kohës ka qenë kundër kësaj marrëveshje, e për më tepër nuk i ka pëlqyer fakti se kjo marrëveshje po lidhet në mes të akuzuarit dhe vëllait të saj, e po ashtu nuk është dakorduar edhe për mënyrën e marrëveshjes (i akuzuari të merr veturën “.....”, kurse si kundër shpërblim të saj të japi një Xhip “.....” një “.....”, një “.....” dhe dy motoçikleta të markës “.....”, e cila marrëveshje është bërë diku tre muaj para ngjarjes së ndodhur e që përfundimisht ka pasur të realizohet ditën ka ndodhur vrasja.

I akuzuari në detaje ka sqaruar sidomos ditën kur për herë të fundit (një ditë para vrasjes) është takuar me Z. në fsh. Bllacë – garazhin e tij, e që pasi ka parë që automjeti ende nuk ishte përfunduar (nuk ishte vendosur motori i ri), e për më tepër ka parë dy apo tre djem të rinj duke biseduar rreth automjetit të tij, e që kishin lënë përshtypjen se Z. po donte t’ia shiste atyre automjetin apo edhe tu merrte ndonjë kapar atyre.

Kurse në fjalën përfundimtare i akuzuari ka deklaruar se ndjen keqardhje për rastin e ndodhur por vrasjen e ka kryer nga pakujdesia ashtu siç është mbrojtur në të gjitha fazat e procedurës penale.

### **3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari B. S, nuk ka pranuar fajësinë për asnjë nga veprat penale sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjatë procedurës hetimore;
- nga dëshmitë e dëshmitarëve – përfaqësuesve të të ndjerës H. S, vëllau i saj Z. S dhe fëmijët e të ndjerës I. S, A. S, Sh. S, R. S, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe procedurës hetimore;
- nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 02.07.2010;
- nga leximi i raportit të autopsisë i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. NA10-179;
- nga leximi i mendimit i ekspertit të balistikës Prof. H. K dhe eksperti i mjekësisë ligjore Dr.T. G, i plotësuar edhe në shqyrtimin gjyqësor;
- nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit i dt. 23.09.2010;
- nga leximi i fotokopjes së armës së gjuetisë dhe dokumenti për riaplikim në emër të të akuzuarit.

### **4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme faktet si në vijim:

- se ditën kritike 2 korrik 2010 me armë të gjuetisë është qëlluar një herë e ndjera H. S;
- se nga plaga e marrë pas disa orësh e ndjera ka vdekur;
- se plaga është shkaktuar me armë të gjuetisë e tipit “TOZ-345P” e kalibrit 12 bore me dy tyta vertikale me numër serik .....
- dhe përfundimisht se e njëjta është qëlluar nga i akuzuari B. S.

Por, Gjykata ka pasur për detyrë që të ndriçoj në këtë çështje penale dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe atë versionin e Prokurorit të Shtetit (se vrasja është kryer me dashje direkte) dhe versionin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij (se vrasja është kryer nga pakujdesia), andaj Gjykata e ndodhur mes këtyre dy

versioneve të arsytimitin e këtij aktgjykimi do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

Sa u përket dëshmive të dëshmitarëve Z. S, Sh. S dhe R. S, këto dëshmi janë përqendruar në sqarimin e raporteve paraprake në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës H. S si dhe në sqarimin e marrëveshjes në mes të të akuzuarit dhe Z. S kurse dëshmitë e tyre lidhur me ngjarjen e ndodhur nuk paraqesin ndonjë relevancë të theksuar meqë këta dëshmitarë nuk kanë qenë prezent në momentin kur ka ndodhur vrasja, për më tepër këta dëshmitarë lidhur me sqarimin e rrethanave në ditën kritike përqendrohen në dëshmitë e dëshmitarëve tjerë okularë I. S dhe A. S.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit- të dëmtuarit Z. S, është vërtetuar fakti se raportet në mes të akuzuarit dhe bashkëshortes së tij tani të ndjerës H. S disa vite pas martesës kanë qenë të mira e që më vonë këto raporte janë çrregulluar, më konkretisht diku një vit para ngjarjes tragjike, pas njoftimit, se motra e tij është rrahur nga ana e të akuzuarit, ka shkuar në fshatin ..... me qëllim që të tejkaloj problemet dhe me këtë rast është insistuar që të tejkalohen problemet për hire të fëmijëve të tyre. Po ashtu, edhe një herë tjetër kur ka shkuar te motra e tij tek e njëjta ka parë një plagë në pjesën e qafës dhe fytit por nuk ka mundur ta dinte si pasojë e ç'kafit ka qenë kjo plagë e që pas bisedës me motrën e tij e njëjta i ka treguar se goditjet janë shkaktuar nga tani i akuzuari. E që edhe këtë herë kanë biseduar për zgjidhjen e problemit, e që B. Si në prezencë të tij ka sharë dhe ka bërtitur, për më tepër edhe përmes një telefonate nga motra e tij ka kuptuar për kërcënimin që B. S i ka bërë asaj duke ia drejtuar pushkën e gjuetisë, e si pasojë e këtyre maltretimeve dhe mosmarrëveshjeve, motra e tij vazhdimisht ka insistuar që të mos jetojnë së bashku më tutje, por, një gjë të tillë nuk e ka përkrahur dëshmitari.

Sa i përket rastit një ditë para ngjarjes tragjike, dëshmitari në rrëfimin e tij ka shtuar, se marrëveshja ka qenë se ditën kritike, të vendos motorin në automjetin “.....”, e që një ditë para kësaj, B. S kishte shkuar në garazhin e tij, e që ka qenë tejet i nervozuar, e si rrjedhojë e kësaj kishin pasur një bisedë tejet të pakëndshme e që ishin ndarë nga njëri tjetri me lënien e një takimi për të nesërmen.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari dhe nga fakti se dëshmia e tij pothuajse janë identike edhe në fazat tjera të procedurës penale dhe përkundër gjendjes së tij të kuptueshme emocionale si pasojë e humbjes që ka pësuar (vdekja e motrës), megjithatë kjo dëshmi është e saktë dhe objektive për më tepër nuk përmban në vete zbrastësi dhe e cila dëshmi është përforcuar edhe përmes dëshmive të dëshmitarëve tjerë veçanërisht dëshmitarëve tjerë Sh. S, A. S, I.S dh R. S (të dhëna gjatë procedurës hetimore).

Dëshmia e këtij dëshmitari është e besueshme edhe nga fakti se i njëjti në mes të sqarimeve të raporteve në mes të tani të ndjerës dhe të akuzuarit i ka përshkruar si raporte jo të mira me probleme të vazhdueshme, si dhe duke e ndërlidhur me faktin se disa herë edhe ka ndërmjetësuar për tejkalimin e problemeve në mes tyre, kurse sa i përket pjesës së dëshmisë së tij që i referohet marrëveshjes në mes tij dhe të akuzuarit dëshmia e tij është në përputhje të plotë edhe me vetë mbrojtjen e të akuzuarit, me që përshkrimi i ngjarjes sidomos një ditë para ngjarjes tragjike dhe biseda e zhvilluar në mes tyre në fshatin Bllacë pothuajse gati e shndërruar edhe në konflikt fizik në mes tyre, e që duke i lënë një takim të mundshëm pikërisht ditën e nesërme, tregon më së miri se sa të tensionuara kanë qenë raportet në mes tyre e të cilat vazhdimisht kanë shkuar duke u tensionuar, prej ditës në ditë e që këto nuk kontestohen as nga vetë i akuzuari (me përjashtim se fajin për mos realizimin e marrëveshjes

ia hedhin njëri-tjetrit), për më tepër është e pakontestueshme se edhe biseda e filluar ditën kritike në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës pikërisht ka pasur të bëjë me marrëveshjen në mes të akuzuarit dhe Z....

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh. S (në shqyrtimin gjyqësor) vërtetohet se raportet në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës H. S kanë qenë raporte të mira dhe nganjëherë ka pasur edhe fjalosje në mes tyre, nuk e ka kontestuar faktin se babai i tij ka përdorur edhe alkool nganjëherë, por përkundër kësaj pas pirjes së alkoolit këtë nuk e ka shprehur me nervozizëm apo me mënyre tjera të dhunshme. Dëshmitari më tutje në rrëfimin e tij ka shtuar se edhe raportet në mes të akuzuarit dhe dajës së tij (Z. S) kanë qenë të mira derisa ato janë përkeqësuar pas një pazari-marrëveshje që kanë bërë këta të dy dhe nga fakti se fillimisht daja i kishte kërkuar një shumë prej 3000€ babait të tij (të akuzuarit) e të cilën shumë nuk ka mundur ta kthej brenda afati të caktuar, andaj, si pasojë e kësaj është lidhur marrëveshja (gojore) që i akuzuari i ka dhënë Z... një “.....”, një Xhip “.....” dy motoçikleta dhe një “.....” kurse Z,... ka pasur që ti japi një “.....”, por që kjo marrëveshje nuk është realizuar nga ana e Z....

Nga dëshmia e dëshmitares R. S, po ashtu edhe kjo dëshmitare ka pohuar faktet se raportet në mes të akuzuarit dhe të ndjerës nënës së saj kanë qenë të mira, duke mos e përjashtuar faktin se i akuzuari ndonjëherë ka pirë alkool, por pas pirjes nuk është manifestuar me dhunë apo sjellje jo të mira, po ashtu e njëjta ka pasur njohuri për një marrëveshje në mes të akuzuarit dhe Z. S, mirëpo e njëjta nuk ka mundur të jep ndonjë sqarim rreth detajeve të kësaj marrëveshjeje pos që ka sqaruar faktin se nga motrat e saj ka dëgjuar se pikërisht para ngjarjes tragjike, se temë e bisedës në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës ka qenë lidhur me marrëveshjen në mes të akuzuarit dhe Z.....

Dëshmitë e dëshmitarëve Sh. S dhe R. S të deponuara në shqyrtimin gjyqësor kanë ndryshime esenciale në krahasim me dëshmitë e tyre gjatë procedurës hetimore, andaj, gjithsesi kjo rrethanë e ndërlidhur edhe me raportet mes të akuzuarit dhe dëshmitarëve (babë dhe fëmijë), ashtu që trajtimin e këtyre dëshmimeve e bën edhe më kompleks dhe shumë më të vështirë se zakonisht, por megjithatë Gjykata e gjendur mes dy deklarimeve të tyre krejtësisht kontradiktore ka vlerësuar se dëshmitë e tyre të deponuara në procedurën hetimore janë objektive, të sakta dhe i ka çmuar të besueshme dhe atë duke e argumentuar si në vijim:

- së pari se dëshmitë e tyre gjatë hetimeve janë të pranueshme me që janë dhënë konform dispozitave ligjore në prani të punëtorëve social (për shkak të moshës së tyre të re), në prani të përfaqësuesve të autorizuar si dhe kujdestarit të përkohshëm ligjor – axhës së tyre F. S;

- se janë dëshmi që në hollësi sqarojnë raportet mes të akuzuarit dhe të dëmtuarës;

- se dëshmitë e tyre janë të pandikuara pasi janë dhënë disa ditë pas ngjarjes;

Tërësisht e kundërt është situata gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe Gjykata dëshmimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u besoi duke u atë bazuar në faktet e mëposhtme:

- së pari vërehet një sinkronizim i pashembullt i dëshmimeve të tyre, që janë tërësisht të ngjashme me njëra tjetrën;

- qartazi vërehet solidarizim i skajshëm me të akuzuarin që është i kuptueshëm dhe i natyrshëm për dëshmitarët (fëmijët) të cilët potencialisht rrezikojnë ta humbin për një kohë edhe babain e tyre;

- në këto raste dëshmitë e tyre duhet ndërlidhur me integritetin e dëshmitarëve që janë dëshmitarë të brishtë dhe të ndikuar nga të afërmit e tyre, meqë edhe jetojnë bashkërisht me ta “... që nga vdekja e nënës dhe ne tani vazhdojmë të jetojmë në shtëpinë e axhës A. S.”<sup>1</sup>, e gjithësi të ndikuar edhe nga vet i akuzuari i cili është vizituar shpesh nga dëshmitarët gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim “...kam ardhë në përfundim se babai nuk është fajtorë për këtë çështje, andaj edhe kam kërkuar që ta vizitoj babain tim në qendrën e paraburgimit...”<sup>2</sup> “... unë gjatë kësaj kohe kam vizituar disa herë babin tim në qendrën e paraburgimit dhe kemi diskutuar edhe punën e mosmarrëveshjes në mes dajës dhe babit...”<sup>3</sup>

Gjykata dëshmime të dëshmitarëve Sh. S dhe R. S, të deponuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk u besoi përkitazi me raportet në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës H. S, meqë këto dëshmi janë në kundërshtim të plotë me dëshmitë e tyre gjatë procedurës hetimore dhe atë për shkak se të njëjtit kanë sqaruar në mënyrë të hollësishme raportet mes të akuzuarit dhe të ndjerës, të citojmë pjesë nga deklaratimet e tyre “...dua të theksoj që babi im B. S edhe disa herë më parë përfaqësohet para një viti e ka frikësuar mamën me pushkë të gjuetisë, kur kanë pasur fjalosje bashkëshortore rreth problemeve të tyre personale...”<sup>4</sup> “...diku përfaqësohet para 7-8 muajve për shkak të një fjalosjeje në mes babit dhe mamit për gjëra të përditshmërisë në jetën e tyre bashkëshortore kam vërejtur babin që në njërin dhomë të shtëpisë t’ia ketë drejtuar pushkën e gjuetisë në drejtim të mamit që ta frikësoj...”<sup>5</sup> “... babai im dhe nëna ime kanë pasur mosmarrëveshje në mes tyre ku babi im gjithmonë ka qenë nervoz...”<sup>6</sup> të gjitha këto dëshmi të ngjashme dhe për më tepër e plotësojnë dhe e përforcojnë dëshminë e njëri-tjetrit deri në atë masë që është e mjaftueshme të vlerësohet se raportet mes të akuzuarit dhe të dëmtuarës kanë qenë të acaruar për një kohë të gjatë e të cilat kanë eskaluar pas marrëveshjes mes të akuzuarit dhe vëllait të të ndjerës.

Nga dëshmia e dëshmitares I. S, është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari është kthyer në kohën e drekës në shtëpinë e tij dhe që gjatë kësaj kohe është zhvilluar një bisedë në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës, biseda fillimisht është zhvilluar në kuzhinë, por, në momentin kur e ndjera ka dashur që të bisedoj me telefon me vëllain e saj Z. S, rreth marrëveshjes të tani të akuzuarit dhe Z, e që tani e ndjera ka insistuar gjithësi që ta ftoj me telefon kurse i akuzuari, i ka thënë që të mos përzihet në këto punë, e që pas kësaj, dëshmitarja e ka larguar tani të ndjerën në dhomën tjetër – dhomën e vëllait të saj Sh, e që në atë dhomë më vonë ka shkuar tani i akuzuari me “llavaqkë” (pushkën e gjuetisë) në dorë e që e ndjera ka qenë e ulur në kauç ndërsa i ndjeri i ulur me dy gjunjtë në tokë duke kërkuar nga e ndjera që të shkojnë në qytet, e që e njëjta vazhdimisht ka refuzuar, derisa gjatë ngritjes në këmbë papritmas pushka ka krisur, duke i “zatet” rripi i pushkës diku, pa mundur të saktësoj se i ka “zatet” në karrige apo në tega, e që distanca në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës ka qenë diku 1m, ashtu që e ndjera është goditur në pjesën e fytyrës me një plumb, duke shtuar

<sup>1</sup> Marrë nga dëshmia e dëshmitares I. S, faqe 13 të procesverbalit të shqyrtimi gjyqësor.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Marrë nga dëshmia e dëshmitarit Sh. S, faqe 7 e procesverbalit të shqyrtimi gjyqësor.

<sup>4</sup> Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit I. S, dhënë në PPQ në Prishtinë

<sup>5</sup> Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit Sh. S, dhënë në PPQ në Prishtinë

<sup>6</sup> Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit A. S, dhënë në PPQ në Prishtinë

se ngjarjen e ka parë në një afërsi prej 1m., ashtu që të akuzuarin e ka parë drejtpërdrejtë në fytyrë kurse të ndjerën e ka parë në profil nga ana e djathtë.

Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitares A. S është vërtetuar se në ditën kritike ka qenë në dhomën ku ka ndodhur ngjarja, e që ka përshkruar se në kohën e drekës, i akuzuari ishte kthyer në shtëpi nga puna, e që biseda në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës ka filluar në momentin kur tani e ndjera ka dashur që ta thërras në telefon vëllain e saj Z..., kurse i akuzuari i ka thënë që të mos e thërret në telefon, e që për këtë arsye edhe janë fjalosur në mes vete, derisa e ndjera ka dalë në dhomën e Sh... dhe është ulur në kauç, e që pas saj aty ka hyrë edhe i akuzuari me pushkën në dorë dhe i ulur në tokë – dysHEME dhe tërë kohën ka livritur pushkën në drejtim të tani të ndjerës H. S dhe distanca në mes tyre ka qenë diku rreth 1m, derisa ka sqaruar përmbajtjen e bisedës se i akuzuari ka pyetur të ndjerën se “a je me mua, a me Z...”, kurse e ndjera është përgjigjur se “jam me ty” dhe në momentin kur i akuzuari ka dashur që të ngritet në këmbë pushka ka kërcitur vetëm njëherë e cila e ka goditur tani të ndjerën, më tutje e njëjta ka shtuar se i akuzuari, pushkën e ka marrë nga kuzhina e cila ka qenë e vendosur në afërsi të TV dhe më pastaj me pushkë në dorë ka hyrë në dhomën e Sh.....

Dëshmitë e dëshmitarëve A. S dhe I. S, paraqesin dëshmitë më të rëndësishme në këtë çështje penalo-juridike nga fakti se këto dëshmi janë të dëshmitarëve okular që ngjarjen e kanë parë dhe përcjell nga një distancë shumë e afërt dhe të njëjtat në hollësi kanë sqaruar tërë rrjedhën e ngjarjes që nga fillimi i bisedës mes të akuzuarit dhe të ndjerës e deri te përfundimi i ngjarjes.

Mirëpo nga fakti se dëshmitë e tyre të deponuara në shqyrtimin gjyqësor kanë ndryshime esenciale në krahasim me dëshmitë e tyre gjatë procedurës hetimore, andaj, Gjykata e gjendur mes dy deklarimeve të tyre kontradiktore ka vlerësuar se dëshmitë e tyre të deponuara në procedurën hetimore janë objektive dhe i ka çmuar të besueshme dhe atë duke e ndërlidhur me argumentet që do ti paraqesim në vijim:

- së pari këto dëshmi janë të pranueshme me që janë dhënë konform dispozitave ligjore në prani të punëtorëve social (për shkak të moshës së tyre të re), në prani të përfaqësuesve të autorizuar si dhe kujdestarit të përkohshëm ligjor – axhës së tyre F. S;

- se janë dëshmi të freskëta vetëm 17 ditë pas ngjarjes së ndodhur;

- se dëshmitë e tyre janë të ngjashme njëra me tjetrën dhe për më tepër e plotësojnë njëra-tjetrën;

- dhe përfundimisht dëshmitë e tyre gjatë procedurës hetimore kanë elaboruar në mënyrë të detajuar tërë ngjarjen e përshkruar.

Natyrisht se Gjykata në kontest të arsytimit të këtij aktgjykimi patjetër e sheh të nevojshme që të elaboroj se pse nuk u besoi dëshmive të dëshmitarëve I dhe A.S të deponuara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe si ndodhi që dëshmitë e tyre të ndryshojnë rëndësisht në shqyrtimin gjyqësor krahas atyre gjatë procedurës hetimore dhe atë:

- së pari duhet pasur parasysh faktin se dëshmitarët janë vajzat e të akuzuarit dhe tani në këtë fazë të procedurës penale po e ndiejnë faktin se mund ta humbin edhe babin e tyre për një kohë;

- në mënyrë të hapët shihet se paraqesin dëshmi favorizuese për të akuzuarin;
- se kanë minimizuar veprimet e të akuzuarit si në ditën kritike e po ashtu edhe para kësaj ngjarje (raporteve bashkëshortore);
- vërehet një sinkronizim i pashembullt i dëshmimeve të tyre që gjithsesi mund të kenë ndikuar edhe nga vet i akuzuari përmes kontakteve pothuajse të rregullta me dëshmitarë gjatë qëndrimit në paraburgim.

Por ti përkujtojmë arsyetimet e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor se si ndodhi që të paraqesin dëshmi “jo të vërteta” gjatë procedurës hetimore e që të gjitha përgjigjet ishin se donin ta dëmtonin të akuzuarin “... këtë e kam bërë nga fakti se kam dashur ta ngarkoj babain më tepër në këtë çështje...”<sup>7</sup> “... kam pasur inatin te babai im kam dashur ta ngarkoj dhe ta paguaj për diçka që nuk ka bërë me faj...”<sup>8</sup>, e këto dëshmi të cituara më së miri tregojnë brishtësinë e këtyre dëshmitarëve dhe qëllimin final të tyre që është vlerësuar më lartë pa harruar asnjëherë raportet dhe kontaktet e tyre pas ngjarjes.

Nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 02.07.2010, në shtëpinë e përbashkët të të akuzuarit dhe të të ndjerës, shihen pushka e gjuetisë e thyer, një rrethatore e lëkurës të vendosur disa plumba, njolla gjaku në dhomën ku është kryer vrasja.

Nga leximi i raportit të autopsisë i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. MA10-179, janë përshkruar plagët e pësura nga tani e ndjera H. S<sup>9</sup> dhe duke konstatuar se vdekja është shkaktuar për shkak të plagëve të marra nga fishekët e armës së zjarrit në kokë dhe plagëve në tru, plaga do të mund të shpjegohet me një të shtënë nga arma e zjarrit e gjuetisë, drejtimi i plagës ishte nga forma frontale në anën e pasme dhe paksa në anën e poshtme në anën e epërme të kokës, gjetjet e tilla në rastin e plagëve nga arma e zjarrit e gjuetisë janë rezultat i të ashtuquajturit “qitje- e shtënë me armë zjarri nga afërsia dmth shkrepje e afërt” dhe se ky rast në praktikën mjeko-ligjore quhet vrasje.

Gjykata raportit të autopsisë i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. S.S, i ka falur besim të plotë me që e njëjta është përpiluar në të arritura shkencore dhe në mënyrë profesionale, për më tepër është përshkruar në mënyrë të detajuar plaga e pësura nga e ndjera, i cili raport është përcjellë edhe me fotografi gjatë autopsisë dhe duke përshkruar në mënyrë të saktë edhe shkakun e vdekjes, për më tepër nuk është gjetur ndonjë rrethanë objektive apo subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtij raporti.

Por megjithatë Gjykata me qëllim të sqarimit më të gjithanshëm të kësaj çështje ka aprovuar propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit dhe ka angazhuar ekspertin e balistikës Prof. H. K dhe ekspertin mjeko-ligjor Dr.T. G, të cilët kanë paraqitur konstatimin dhe mendimin e tyre<sup>10</sup>, e të cilët kanë përshkruar se tyre pushka e gjuetisë me të cilën është shtënë është me dy tyta vertikale, shpejtësia fillestare e sferave që dalin prej tytës kanë shpejtësinë prej 375 m/sek, të njëjtat shpërndahen në formë hinke, kurse nga të shtënat provuese nga pushka e

<sup>7</sup> Dëshmia e dëshmitares R. S, faqe 14 e procesverbalit nga shqyrtimi gjyqësor.

<sup>8</sup> Dëshmia e dëshmitares I. S, faqe 13 e procesverbalit nga shqyrtimi gjyqësor.

<sup>9</sup> Shih raportin e autopsisë të datës 05.07.2010.

<sup>10</sup> Shih konstatimin dhe mendimin e ekspertit të balistikës Prof. H.K dhe ekspertin mjeko-ligjor Dr.T. G

gjuetisë me kalibër të njëjtë kanë treguar se sferat dalin prej tytës dhe shkojnë komplet 2-3 m. e pastaj fillojnë të shpërndahen pas 15 metra largësi dhe duke konstatuar se distanca prej daljes nga tyta deri te objekti (koka e të ndjerës) prej 2 metra largësi, kurse rregullorja anatomike e predhës nëpër kokë është nga ana e përparme e djathtë në atë të pasme të majtë dhe nga poshtë lehtësisht lart.

Megjithatë ekspertët kanë sqaruar mendimin e tyre në shqyrtimin gjyqësor, të cilët kanë pohuar se distanca e qitjes mund të jetë edhe më afër se 2m. përkatësisht maksimumi në mes qitjes dhe objektit trupit të të ndjerës ka qenë 2m përkatësisht prej tytës deri tek vrima hyrëse largësia ka mund të jetë edhe më e vogël se 2m, duke vazhduar se predha e shkrepjes nga kjo pushkë e gjuetisë deri në 2m. shkon si e plotë kompletë kurse në largësi më të madhe 2m. atëherë shpërndahen të veçuara sferat (saçmet).

Sa i përket trajektorës eksperti jep këto sqarime në qoftë se personi qëndron vertikalisht sapo edhe ulur me kokë të kthyer përpara trajektorja e predhave (saçmeve apo sferëzave) nëpër kokën e tani të ndjerës H. S e kanë drejtimin nga ana e përparme e djathtë në anën e pasme të majtë dhe nga poshtë lehtësisht lartë. Mirëpo me qenë se në rastin konkret bëhet fjalë për kokën si pjesë të lëvizshme asnjëherë eksperti me siguri nuk mund dhe nuk duhet ta përcaktojë distancën gjegjësisht pozitën në mes të kryesit të veprës dhe viktimës, pasi që koka është pjesë e lëvizshme pra në rastin konkret ekzistojnë shumë pozita të mundshme të shkaktueshmërisë së këtyre dëmtimeve, duke përfunduar se plaga ka atakuar pjesë të organit me rëndësi jetësore si në rastin konkret të hemisferës së majtë të tij dhe praktikisht ka shkaktuar dëmtime vdekjeprurëse ku ndihma adekuate mjekësore edhe po të ishte dhënë në vendin e ngjarjes nuk ka mundur t'ia shpëtoj jetën tani të ndjerën H. S.

Gjykata i vlerëson të besueshme dhe objektive mendimin dhe konstatimin e ekspertëve si në paraqitjen e mendimit të tyre me shkrim po ashtu edhe sqarimet e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor, meqë janë dhënë në baza shkencore dhe profesionale se bëhet fjalë për ekspertë të fushave përkatëse e mbi të gjitha me përvojë të gjatë në këto lëmi, e nuk është gjetur ndonjë rrethanë subjektive apo objektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e tyre, e për më tepër sa i përket distancës së qitjes ekspertiza përputhet në tërësi edhe me dëshmitë e dëshmitarëve okular I dhe R. S të cilat pohojnë se distanca mes të akuzuarit dhe të ndjerës ka qenë rreth 1 metër.

Nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit i dt. 23.09.2010, i cili konkludim ka ardhur si rezultat i katër gjuajtjeve testuese nga e njëjta pushkë dhe vërtetohet se janë ekzaminuar sipas dëshmisë D#4, një pushkë gjuetie e modelit TOZ-345 P e kalibrit 12 bore me dy tyta vertikale me nr.serik "....." dhe kjo pushkë është funksionale dhe dëshmia D#9, është një gëzhgjë e pjesës së fishekut të kalibrit 12 bore e cila është shkrepur nga tyta e poshtme nga pushka e gjuetisë e modelit TOZ-345 P e kalibrit 12 bore me dy tyta vertikale me nr.serik ".....", nga dëshmia D#4.

Po ashtu sa i përket ekspertizës për armën e zjarrit, ekspertiza është përpiluar në mënyrë profesionale dhe nga autoriteti kompetent, nuk pati ndonjë arsye të veçantë që të mos i besohet, por vlen të theksohet se këto të gjetura nga ekspertiza edhe nuk kanë qenë kontestuese.

Nga leximi i fotokopjes së armës së gjuetisë vërtetohet se i akuzuari ka pasur leje valide për armën e gjuetisë dhe atë në periudhën kohore deri me 25 korrik 2005 dhe dokumenti për ri aplikim në emër të të akuzuarit, por gjithsesi është e qartë dhe e pakontestueshme se afati i

lejes ka skaduar dhe se aplikimi assesi nuk nënkupton që i akuzuari ka pasur leje për armën e gjuetisë.

## **5.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit B. S**

Mbrojtja e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale është përqendruar në paraqitjen se veprimi i tij ka qenë nga pakujdesia.

Mbrojtja e të akuzuarit nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër relevante pos përmes mbrojtjes së tij dhe mbështetjes nga dëshmitarët (gjatë shqyrtimit gjyqësor), andaj rrjedhimisht analiza e mbrojtjes së tij, nuk duhet bërë në mënyrë fragmentare dhe të shkëputura prej provave tjera, por ti gërshetohet të njëjtat dhe në bazë të tyre të sjell konkluzione bazuar në logjikën dhe në kontest të tërësisë së ngjarjes, për këtë arsye edhe mbrojtja e të akuzuarit duhet të vlerësohet në këtë kontekst.

Por, Gjykata nuk ka aprovuar pretendimet e të akuzuarit dhe atë duke u mbështetur në këto fakte:

- së pari është e pakontestueshme se vrasjes i ka parapri një marrëveshje apo më mirë të themi mosmarrëveshje përkatësisht ndërrim i automjeteve mes të akuzuarit dhe vëllait të të ndjerës (Z. S), e cila është përshkruar po thuajse në version të njëjte nga i akuzuari dhe dëshmitarët.

-është më se e qartë se tensionet mes tyre po rriteshin gradualisht gjatë katër muajve duke arritur kulminacionin pikërisht një ditë para ngjarjes siç shprehet edhe vet i akuzuari *“...e kam lënë që të hënën në ora 4:00 të takohem me të dhe i kemi lënë fjalët peng me të sepse ose ka për të ma rregulluar veturën ose ka për të na dalë problem, atëherë gruaja më tha se unë atë e kam vëlla dhe mos kujto se vetëm ti ke pushkë...”*,<sup>11</sup> për të vazhduar më tutje fjalët *“...a po e kryen punën apo jo, se t’isha kanë me dikë tjetër ndryshe isha marrë vesh”* e për të vazhduar më tutje se *“edhe shoqëria ime po bëjnë hajgare edhe s’po di çka ti them edhe gruas për këtë punë”*,<sup>12</sup> që tregon karakterin e një personi tipik konzervativ i veshur me petkun e një krenarie e që dita ditës po konsideronte se po i thyhej dhe nëpërkëmbej nga vëllai i gruas së tij, përmes shtyrjes së afatit për rregullimin e automjetit të tij.

- edhe vet ngjarjes ditën kritike i ka paraprirë pikërisht biseda rreth ndërrimit të automjeteve, duke u zhvilluar një bisedë së pari në sallon për të vazhduar në dhomën e Sh, e që e ndjera insistonte që ti telefononte vëllait të saj pikërisht rreth kësaj çështje e që nuk po lejohej nga i akuzuari siç pohohet edhe nga dëshmitarët *“...problemin që ka pasur babi me dajën rreth ndërrimit të automjeteve më kujtohet që mami vazhdimisht donte që ta thërriste dajën në telefon dhe babi i thoshte që të mos përzihej në këto punë...”*,<sup>13</sup> e po ashtu *“...mami im ka dashur që ta thërret me telefon vëllain e saj dajën tim Z, kurse babi ka thënë që të mos e thërret atë në telefon kështu që babi dhe mami janë fjalosur atë ditë...”*.<sup>14</sup>

- dhe sa të pabazuara dhe absurde janë pretendimet e të akuzuarit se është zhvilluar një bisedë e zakonshme vërtetohet me faktin se tërë biseda është zhvilluar me pushkë në dorë për të cilën i akuzuari nuk ka sqarim se përse e ka mbajtur në dorë, por shprehet se pikërisht kur

<sup>11</sup> Procesverbali i intervistimit të të pandehurit marrë gjatë procedurës hetimore.

<sup>12</sup> Shif në tërësi mbrojtjen e të akuzuarit, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor faqe 19, 20, 21, 22.

<sup>13</sup> Shih më hollësisht deklarinimin e dëshmitares I. S në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

<sup>14</sup> Shih më hollësisht deklarinimin e dëshmitares A. S në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

ka dëgjuar të ndjerën në korridor duke thënë që ti kapin pushkët e ka marrë pushkën në dorë, në këtë kontest shtrohet një pyetje logjike se në të vërtetë a konsiderohet një bisedë “normale apo e zakonshme” (pretendimi i të akuzuarit) me pushkë në dorë, andaj është tërësisht e panevojshme të trajtohet më tutje pretendimi i të akuzuarit.

Kurse sa i përket pretendimit të tij lidhur me veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së përkatësisht se aplikimin e tij për leje të armës së gjuetisë, Gjykata vlerëson se leja me afat të skaduar dhe riaplikimi nuk nënkuptojnë se ekziston leja përkatëse por se është e nevojshme që leja të posedohet dhe atë brenda periudhës kohore të përshkruar në leje.

## **6. Vlerësimi i tezës së mbrojtësit të të akuzuarit B. S av. A. I**

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit B. S av. A. I<sup>15</sup> të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar që Gjykata të mos pranon cilësimin juridik sipas pretendimit të Prokurorit të Shtetit për veprën penale vrasja nga neni 146 i KPK-së, por veprimet e të akuzuarit ti cilësoi si vepër penale vrasja nga pakujdesia nga neni 149 i KPK-së.

Por Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

- së pari Gjykata nuk e ka as dilemën edhe më të vogël se raportet mes të akuzuarit dhe të ndjerës ishin me vite raporte jo të mira e që jo rrallë herë ishin manifestuar edhe me rrahje të së ndjerës ti përkujtojmë dëshmitë e dëshmitarit Z. S në të gjitha fazat e procedurës dhe dëshmitë e dëshmitarëve Sh. S, I.S, A. S dhe R. (në fazën e hetimeve) të elaboruara hollësisht në pjesën ku janë vlerësuar dëshmitë e tyre e që në tërësi e demantojnë pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit se raportet ishin të mira dhe nuk ishin luhatur përkundër zvarritjes për realizimin e obligimit nga Z. S.

- pretendimi tjetër se i akuzuari nuk ka qenë në dijeni se arma ka qenë e mbushur me fishekë dhe se nuk ka qenë e drejtuar në të ndjerën po ashtu nuk janë argumentuar përkatësisht janë demantuar nga vet i akuzuari, i cili natyrshëm ka pohuar se “...*më kujtohet mirë se e kam mbushur pushkën me dy fishek në dy tytat dhe kam shkuar për të kontrolluar tek punëtorja ime, por, mbushjen e kam bërë për shkak të sigurisë nga qentë...*”<sup>16</sup>, e kur kësaj i shtojmë faktin që i akuzuari ka qenë një gjahtar me një përvojë të gjatë, atëherë ky pretendim është i paqëndrueshëm për më tepër me orientim të qartë që të minimizoj përgjegjësinë e të akuzuarit.

## **7. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit B. S**

Duke vlerësuar në aspektin juridik, Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasja nga neni 146 të KPK-ës, meqë janë realizuar elementet *actus reus (elementi i jashtëm)*, *i vërtetuar përmes faktit se kemi të bëjmë me privim në mënyrë të kundërligjshëm nga jeta të personit tjetër me elementet përbërës të tij:*

<sup>15</sup> Fjala përfundimtare e av. A. I e paraqitur në formën me shkrim.

<sup>16</sup> Shih më hollësisht mbrojtjen e të akuzuarit në faqe 21 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

- ekziston lidhja kauzale mes veprimit të akuzuarit (përmes shkrepjes një herë me pushkë të gjuetisë në drejtim të të dëmtuarës) dhe pasojës së shkaktuar (vdekja nga plaga e marrë)

*Kurse elementi i lartcekur ndërlidhet edhe me elementin mens rea (qëllimi i brendshëm mendor kriminal), i vërtetuar përmes veprimeve konkrete të të akuzuarit*

- se i akuzuari ishte i vetëdijshëm se përmes veprimit të tij të manifestuar shkrepjes me armë në drejtim të tani të ndjerës do të shkaktohej vdekja.

- i shprehur edhe përmes aspektit volutiv, për më tepër nuk ka si të shpjegohen ndryshe veprimet e mësipërme të të akuzuarit pos që me dashje direkte për kryerjen e kësaj vepre penale.

### **8. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin B. S, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari është prind i nëntë fëmijëve disa nga ta të moshës së mitur të mbetur pa përkujdesje të nevojshme prindore, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shprehur keqardhje (për vdekjen e të ndjerës duke aluduar në vrasje nga pakujdesia), se deri më tani nuk rezulton se të jetë dënuar me ndonjë dënim të formës së prerë, por, gjithsesi këto rrethana paraqesin rrethana minore kundruall rrethanave rënduese dhe atë në rrethanën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale të vrasjes e kryer në prani të fëmijëve të tyre të përbashkët disa nga ta të moshës së mitur që gjithsesi do të jetë një storie mjaft e rëndë dhe e dhimbshme për ta, në motivin e kryerjes së kësaj vepre penale (mosmarrëveshje me vëllain e të ndjerës) dhe se kontributi i të ndjerës në këto raporte ka qenë shumë i parëndësishëm si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale duke vepruar me një këmbëngulësi, agresivitet dhe vendosmëri të një shkalle mjaft të lartë.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 34 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

### **9.Llogaritja e paraburgimit, kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale**

Në dënimin e shqiptuar është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit duke aplikuar nenin 71 par. 1 të KPK-ës, kurse në kuptim të nenit të nenit 393 par.5 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë është vazhduar masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

Konform nenit 112 par.1 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar përfaqësuesin e palës së dëmtuar dhe atë vëllain e saj Z. S dhe vajzën e të ndjerës I. S, që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizojnë në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruara gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishme për të vendosur lidhur me

këtë kërkesë, kurse të dëmtuarit tjerë fëmijët e të ndjerës, A. S, R. S nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridik.

Konform neneve 99 dhe 102 të KPPK-ës, obligohet i akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 100 /njëqind/€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 350.06€, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me PKR.nr.5/2013 – P259/10 PR1**

**Sekretarja juridike,  
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Agim MALIQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj. Përfaqësuesi i të dëmtuarit mund të ushtroj ankesë ndaj këtij aktgjykimi vetëm për vendimin e Gjykatës lidhur me sanksionin penal.